



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**INSPEKTORATI I LARTË I DEKLARIMIT DHE KONTROLLIT TË PASURIVE**  
**DHE KONFLIKTIT TË INTERESAVE**

Adresa: Rr.Reshit Çollaku, Tel: 0800 9999, Ëebsite: [ee.ee.hidaa.gov.al](http://ee.ee.hidaa.gov.al), E-mail: [info@hidaa.gov.al](mailto:info@hidaa.gov.al)

Nr. Indeksi  
në ILDKPKI  
dhe Viti

2019

**DEKLARATË E INTERESAVE PRIVATE**  
**PERIODIK / VJETOR**

Plotësohet nga subjekti deklarues (zyrtari) që mbart detyrimin për deklarim të interesave private të tij, të bashkëshortit/es bashkëjetuesit/es dhe të fëmijëve madhorë, në bazë të Ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, me ndryshimet e pasqyruara në Ligjin nr. 9367, datë 7.4.2005, Ligjin nr. 9475, datë 9.2.2006, Ligjin nr. 9529, datë 11.5.2006, Ligjin nr. 85/2012, datë 18.9.2012, Ligjin nr. 45/2014, datë 24.4.2014 dhe Ligjin nr. 42/2017, datë 6.4.2017.

**A U T O R I Z I M**  
**PËR KONTROLLIN E DEKLARATËS SË INTERESAVE PRIVATE**

Emri

ESMERALDA

Atësia

ZYDI

Mbiemri

XHILI (ÇEKA)

Funksioni

GJYQTARE

Institucioni dhe adresa

GJYKATA E RRETHIT GJYQESOR LUSHNJE

Data e emërimit në funksionin që kryen

05.10.2007

Data e dorëzimit të deklaratës

22.05.2020

Në bazë të nenit 9/1, të Ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar,

**A u t o r i z o j:**

Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave dhe personat e autorizuar nga Autoriteti Përgjegjës -Inspektori i Përgjithshëm i ILDKPKI-së, që të verifikojnë në të gjitha subjektet private e publike, brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë, pasuritë, interesat private dhe detyrimet financiare, që ekzistojnë në emër dhe për llogarinë time.

Deklaroj se të dhënat e pasqyruara prej meje në këtë dokument janë të vërteta dhe nuk kam deklaruar asgjë që nuk është e vërtetë.

Nënshkrimi i subjektit deklarues

 2020

**NDRYSHIMET E PASURIVE  
DHE  
BURIMI I KRIJIMIT**

Përshkruani hollësisht ndryshimet (shtesa dhe pakësime) në: llojin, sipërfaqen, adresën ku ndodhen, momentin e kryerjes së veprimit, vlerën në lekë apo në valutë që pasqyrohet në dokumentacionin që dispononi, çmimin e blerjes, në mungesë të dokumenteve vlerën që keni shtuar apo pakësuar, pjesën takuese që zotëroni të çdo lloj pasurie\*, të regjistruar ose jo në regjistrat publikë, brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë, për periudhën nga deklarimi i mëparshëm deri në 31 Dhjetor të vitit të deklarimit.

| Nr. | Përshkrimi i pasurisë dhe burimi i krijimit                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                       | Vlera me shifra dhe me fjalë                                                                                                                                                                   | Pjesa në %                                           |
|-----|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|------------------------------------------------------|
|     | Tokë në bashkëpronësi e përfutur nga ligji 7501 datë 19.07.1991, si anëtare e familjes bujqësore, tokë arë dhe ullishte, gjithsej 4800 m2, e ndodhur në fshatin [REDAKTUAR]<br>Ndreq Tiranë (siç është deklaruar në deklaratat e mëparshme)                                                                                                                                                                                                                                       |                                                                                                                                                                                                | Pjesa takuese si bashkëpronare, sipas ligjit nr.7501 |
|     | Apartament, numër pasurie [REDAKTUAR] e ndodhur në Rruga ' [REDAKTUAR]', hyrja [REDAKTUAR] ap. [REDAKTUAR] Tiranë, me sipërfaqe 82.50 m2, e regjistruar në vo [REDAKTUAR] faqe [REDAKTUAR] ZK [REDAKTUAR] Kjo pasuri është blerë nga unë dhe shtetasi Alan Xhili (bashkëshorti). Rrjedhimisht, ky apartament është në bashkëpronësi me bashkëshortin Alan Xhili.<br>Në deklaratat e mëparshme, është deklaruar lidhur me të ardhurat që kanë shërbyer për blerjen e apartamentit. | Pasuria është blerë në vlerën totale 80 000 (tetëdhjetë mijë) euro ose konvertuar në lekë, sipas kontratës 10 886 400 (dhjetë milion e tetëqind e tetëdhjetë e gjashtë mijë e katërqind) lekë. | Pjesa takuese, ½ unë dhe ½ bashkëshorti              |
|     | Në llogari plan kursimi, në emrin tim, me numër [REDAKTUAR], gjendja e llogarise deri në datë 31.12.2019 është 95 022.86 lekë. Kjo llogari është krijuar nga derdhjet periodike nga llogaria e pagës si Gjyqtar.                                                                                                                                                                                                                                                                  | 95 022.86 (nëntëdhjetë e pesë mijë e njëzet e dy pikë tetëdhjetë e gjashtë) lekë                                                                                                               | 100%                                                 |
|     | Në llogari rrjedhëse, në emrin tim, me numër [REDAKTUAR], gjendja e llogarisë deri në datë 31.12.2019 është 8 680 lekë                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                            | 8 680 (tetëmijë e gjashtëqind e tetëdhjetë) lekë                                                                                                                                               | 100%                                                 |
|     |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                   |                                                                                                                                                                                                |                                                      |

\* **Objekti i deklarimit** (Neni 4, gërma a, b, c, ç, d i ligjit nr.9049, datë 10.4.2003, i ndryshuar)

- pasuritë e paluajtshme dhe të drejtat reale mbi to, sipas Kodit Civil;
- pasuritë e luajtshme, të regjistrueshme në regjistrat publikë dhe të drejtat reale mbi to, sipas Kodit Civil;
- sendet me vlerë të veçantë mbi 300 000 lekë;
- vlerën e aksioneve, të letrave me vlerë dhe pjesët e kapitalit në zotërim;
- vlerën e likuiditeteve, gjendje në **Cash**, jashtë sistemit bankar, në llogari rrjedhëse, në depozitë, në bono thesari dhe në huadhënie, në lekë ose në valutë të huaj.

Nëse ky format është i pamjaftueshëm, vazhdoni të plotësoni në kopje të tij.

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi i subjektit deklarues

ESMERALDA XHILI 2020



**TË ARDHURAT DHE ANGAZHIMET  
NË VEPRIMTARI  
PUBLIKE DHE/OSE PRIVATE**

Angazhime në veprimtari private dhe/ose publike me qëllim fitimi dhe çdo lloj veprimtarie e kryer brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë, që ka krijuar të ardhura, si dhe angazhime në organizata fitimprurëse dhe jo fitimprurëse, liçensa dhe patenta që sjellin fitim, sindikata ose organizata profesionale, politike, shtetërore dhe pjesëmarrje në çdo organizatë tjetër; për periudhën nga data e deklarimit të mëparshëm deri në 31 Dhjetor të vitit të deklarimit.

Përshkruani hollësisht të ardhurat brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë për vitin, nga paga ose pjesëmarrja në borde, komisione e çdo angazhim e veprimtari tjetër që ka sjellë të ardhura për subjektin, për bashkëshortin/en, bashkëjetuesin/en dhe fëmijët madhorë. Përcaktoni emërtimin e institucionit, organizatës apo aktivitetit nga ku janë siguruar të ardhurat, adresa, nr. i regjistrat publik, statusi, objektin e veprimtarisë së organizatës, funksionin, natyrën e angazhimit, nga deklarimi i mëparshëm deri më 31 Dhjetor të vitit të deklarimit.

| Përshkrimi i të ardhurave                                                                                                                                | Shuma e të ardhurave <u>neto</u> të krijuara, në lekë apo në valutë (me shifra dhe me fjalë) |
|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----------------------------------------------------------------------------------------------|
| Të ardhura nga paga si Gjyqtare për vitin 2019.                                                                                                          | 2 432 870 (dy milion e katerqind e tridhjetë e dy mije e teteqind e shtatedhjetë) lekë.      |
| Të ardhura nga paga, e bashkëshortit Alan Xhili, si Oficer i Policisë Gjyqësore pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Kavaje dhe Tiranë, për vitin 2019. | 1 434 233 (një milion e katërqind e tridhjetë e kater mije e dyqind e tridhjetë e tre) lekë. |
|                                                                                                                                                          |                                                                                              |
|                                                                                                                                                          |                                                                                              |
|                                                                                                                                                          |                                                                                              |
|                                                                                                                                                          |                                                                                              |

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi i subjektit deklarues

ESMERALDA XHILI  2020

Nëse ky format është i pamjaftueshëm, vazhdoni të plotësoni në kopje të tij.

**DETYRIMET FINANCIARE  
NDAJ PERSONAVE JURIDIKË DHE FIZIKË**

Detyrimet financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë (kredi, huamarrje, detyrim ndaj të tretëve etj.) që ekzistojnë brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë, të mbetura ende pa u shlyer për periudhën nga deklarimi i mëparshëm deri në 31 Dhjetor të vitit të deklarimit, si dhe detyrimet e lindura për subjektin gjatë vitit të deklarimit.


Të dhënat për emra personash ndaj të cilëve subjekti deklarues ka detyrime financiare, të pasqyrohen në faqen nr. 7, për të ruajtur konfidencialitetin e tyre.

Përshkruani hollësisht qëllimin e detyrimit financiar, shumën totale në lekë apo në valutë, datën e fillimit dhe të mbarimit të detyrimit (muaji/viti), nr. e kontratës dhe interesin bazë. Për kreditë bankare shumën e kredisë (principal), kohëzgjatjen (muaji/viti) dhe kësti mujor.

| Përshkrimi i detyrimeve                                                                                                                                                                                                                                | Shuma e shlyer nga deklarimi i mëparshëm deri në 31 Dhjetor të vitit të deklarimit (me shifra dhe fjalë)                                                                                                                                                                                                                                                                                                                       | Gjendja e detyrimit të mbetur pa shlyer deri në 31 Dhjetor të vitit të deklarimit (me shifra dhe fjalë)                                                                                   |
|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| Kredi e marrë pranë "Bank", sipas kontratës bankare dhe hipoteke me nr. rep. kol. datë 31.03.2017. Kjo kredi është marrë nga ana ime, si kredimarrëse dhe e bashkëshortit Alan Xhili, si bashkëkredimarrës. Kjo kredi është marrë përgjatë vitit 2017. | Kredia është marrë në vlerën 8 700 000 (tetë milion e shtatëqind mijë) lekë, për blerje shtëpie. Kredia është marrë për afatin 15 vjet, me këste mujore. Nga janari-prill 2019, kesti mujor është 64 590.24 (gjashtëdhjetë e kater mije e peseqind e nentëdhjetë pike njezet e kater) leke. Nga maji-dhjetor 2019, kesti është 59 674.22 (pesëdhjetë e nente mije e gjashtëqind e shtatëdhjetë e kater pike njezet e dy) leke. | Gjendja e detyrimit të mbetur pa shlyer deri në datë 31.12.2019, është 7,469,641.40 (shtatë milion e katërqind e gjashtëdhjetë e nëntë mijë e gjashtëqind e dyzet e një pikë dyzet) lekë. |
|                                                                                                                                                                                                                                                        |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                |                                                                                                                                                                                           |
|                                                                                                                                                                                                                                                        |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                |                                                                                                                                                                                           |
|                                                                                                                                                                                                                                                        |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                |                                                                                                                                                                                           |

Nëse ky format është i pamjaftueshëm, vazhdoni të plotësoni në kopje të tij.

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi i subjektit deklarues

ESMERALDA XHILI 





**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**INSPEKTORATI I LARTË I DEKLARIMIT DHE KONTROLLIT TË PASURIVE**  
**DHE KONFLIKTIT TË INTERESAVE**

Adresa: Rr.Reshit Çollaku, Tel: 0800 9999, Ëëbsite: [ee.hidaa.gov.al](http://ee.hidaa.gov.al), E-mail: [info@hidaa.gov.al](mailto:info@hidaa.gov.al)

Nr. Indeksi  
në ILDKPKI

**DEKLARATË E INTERESAVE PRIVATE**  
**E PERSONIT TË LIDHUR**

Plotësohet dhe nënshkruhet nga personi i lidhur me subjektin deklarues (bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi/ja, fëmijët madhorë) që mbartin detyrimin për deklarim në bazë të nenit 22 të Ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, për pasuritë që disponohen veçmas.

**A U T O R I Z I M**  
**PËR KONTROLLIN E DEKLARATËS SË INTERESAVE PRIVATE**

Në bazë të nenit 9/1, të Ligjit nr.9049, datë 10.4.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë” i ndryshuar,

**Autorizoj:**

Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit dhe personat e autorizuar nga Autoriteti Përgjegjës - Inspektori i Përgjithshëm i ILDKPKI-së, që të verifikojnë në të gjitha subjektet private e publike, brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë, pasuritë, interesat private dhe detyrimet financiare, që ekzistojnë në emër dhe për llogarinë time.

Shtetasi/ja **Alan Murat Xhili, bashkëshorti/ja**

**Emër, Atësi, Mbiemër**

**fëmijë madhorë së bashku me prindërit**

**fëmijë madhorë të ndarë nga prindërit**

**bashkëjetuesi/ja**

☒  
☐  
☐  
☐

i/e Subjektit **Esmeralda Zydi Xhili (Çeka)**

**Emër, Atësi, Mbiemër**

**Jam njohur me detyrimet që sanksionon legjislacioni në fuqi dhe deklaroj nën përgjegjësinë time ligjore se:**

Disponoj pasuri veçmas të regjistruar në emrin tim ☒

Nuk disponoj pasuri veçmas të regjistruar në emrin tim ☐

**Deklaroj se të dhënat e pasqyruara prej meje në këtë dokument janë të vërteta dhe nuk kam deklaruar asgjë që nuk është e vërtetë.**

**Emri, Mbiemri, Nënshkrimi i personit të**

**ALAN XHILI**

# NDRYSHIMET E PASURIVE DHE BURIMI I KRIJIMIT

Përshkruani hollësisht ndryshimet (shitesa dhe pakësime) në: llojin, sipërfaqen, adresën ku ndodhen, momentin e kryerjes së veprimit, vlerën në lekë apo në valutë që pasqyrohet në dokumentacionin që dispononi, çmimin e blerjes, në mungesë të dokumenteve vlerën që keni shtuar apo pakësuar, pjesën takuese që zotëroni, të çdo lloj pasurie\*, të regjistruar ose jo në regjistrat publikë, brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë për periudhën nga deklarimi i mëparshëm deri në 31 Dhjetor të viti të deklarimit.

| Nr. | Përshkrimi i pasurisë dhe burimi i krijimit                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                      | Vlera me shifra dhe me fjalë                                                                                                                                                | Pjesa në % |
|-----|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|------------|
|     | Apartamenti (shtëpi banimi), numër pasurie [redacted] i deklaruar në deklaratën e mëparshme, është shitur nga ana ime dhe nënës time si bashkëpronarë, sipas kontratës së shitjes me nr. [redacted] rep. [redacted] kol. datë 08.07.2019. Ky apartament është shitur në vlerë totale 6 200 000 (gjashtë milion e dyqind mijë) lekë.                                              | Është shitur në vlerën 6 200 000 (gjashtë milion e dyqind mijë) lekë. Unë si bashkëpronar, nga kjo shitje, kam përfituar vlerën 3 100 000 (tre milion e njëqind mijë) lekë. |            |
|     | Automjet tip "DAIMLER 203", vit prodhimi 2004, blerë në vitin 2016. Është deklaruar në deklaratat e mëparshme.                                                                                                                                                                                                                                                                   | Është deklaruar në deklaratat e mëparshme.                                                                                                                                  | 100%       |
|     | Gjendja e llogarisë rrjedhese në emrin tim, deri në datë 31.12.2019                                                                                                                                                                                                                                                                                                              | Vlera 76 297.50 (shtatëdhjetë e gjashtë mijë e dyqind e nëntëdhjetë e shtatë pikë pesëdhjetë) lekë.                                                                         | 100%       |
|     | Gjendja e llogarisë në emrin tim, sipas kontratës së depozitës datë 21.11.2019, me "[redacted] Bank" është 3 000 000 (tre milion) lekë. Kjo shumë është krijuar nga të ardhurat e shitjes së apartamentit në bashkëpronësi, si më lart cituar dhe të ardhurat e krijuara nga dhurimi i bërë nga nëna ime, [redacted] në vlerën 1 000 000 (një milion) lekë, shpjeguar më poshtë. | 3 000 000 (tre milion) lekë.                                                                                                                                                | 100%       |
|     | Për pasurinë që kam në bashkëpronësi me bashkëshorten, apartament (shtëpi banimi) [redacted], është deklaruar më lart nga bashkëshortja Esmeralda Xhili (Çeka).                                                                                                                                                                                                                  |                                                                                                                                                                             |            |

\*Objekti i deklarimit (Neni 4, gërma a, b, c, ç, d i Ligjit nr.9049, datë 10.4.2003, i ndryshuar)

- a) pasuritë e paluajtshme dhe të drejtat reale mbi to, sipas Kodit Civil;
- b) pasuritë e luajtshme, të regjistrueshme në regjistrat publikë, dhe të drejtat reale mbi to, sipas Kodit Civil;
- c) sendet me vlerë të veçantë mbi 300 000 lekë;
- ç) vlerën e aksioneve, të letrave me vlerë dhe pjesët e kapitalit në zotërim;
- d) vlerën e likuiditeteve, gjendje në **Cash** jashtë sistemit bankar, në llogari rrjedhëse, në depozitë, në bono thesari dhe në huadhënie, në lekë ose në valutë të huaj;

Nëse ky format është i pamjaftueshëm, vazhdoni të plotësoni në kopje të tij.

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi i personit të lidhur

ALAN XHILI



**TË ARDHURAT DHE ANGAZHIMET NË  
VEPRIMTARI PUBLIKE DHE/OSE PRIVATE**


Angazhime në veprimtari private dhe/ose publike me qëllim fitimi dhe çdo lloj veprimtarie e kryer brenda ose jashtë territorit të Shqipërisë, që ka krijuar të ardhura, si dhe angazhime në organizata fitimprurëse dhe jo fitimprurëse, liçensa dhe patenta që sjellin fitim, sindikata ose organizata profesionale, politike, shtetërore dhe pjesëmarrje në çdo organizatë tjetër; për periudhën nga data e deklarimit të mëparshëm deri në 31 Dhjetor të vitit të deklarimit.

Përshkruani hollësisht të ardhurat për vitin, nga paga ose pjesëmarrja në borde, komisione e çdo angazhim e veprimtari tjetër që ka sjellë të ardhura personale, për bashkëshortin/en, bashkëjetuesin/en dhe fëmijët madhorë. Përcaktoni emërtimin e institucionit, organizatës apo aktivitetit nga ku janë siguruar të ardhurat, adresa, nr. i regjistrimit publik, statusi, objektin e veprimtarisë së organizatës, funksionin, natyrën e angazhimit, nga deklarimi i mëparshëm deri më 31 Dhjetor të vitit të deklarimit.

| Përshkrimi i të ardhurave                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                             | Shuma e të ardhurave <u>neto</u> të krijuara, në lekë apo në valutë (me shifra dhe me fjalë)                                                                                                                        |
|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| Të ardhura nga paga neto, si Oficer i Policisë Gjyqësore pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Kavaje dhe Tiranë, për vitin 2019.                                                                                                                                                                                                                                                                     | 1 434 233 (një milion e katërqind e tridhjetë e katër mijë e dyqind e tridhjetë e tre) lekë.                                                                                                                        |
| Të ardhura e përfituara nga shitja e pasurisë në bashkëpronësi me nënën time [redacted] apartament numër pasurie [redacted] e ndodhur në Rrugë [redacted] p. sh. [redacted] k. ap. [redacted] Tiranë, me sipërfaqe 55.6 m2. Kjo pasuri është shitur sipas kontratës së shitjes me nr. [redacted] rep. [redacted] kol. datë 08.07.2019, në vlerë totale 6 200 000 (gjashtë milion e dyqind mijë) lekë. | Nga shitja e apartamentit unë kam marrë vlerën prej 3 100 000 (tre milion e njëqind mijë) lekë, që i korrespondon pjesës në bashkëpronësi që kam patur. Pjesa tjetër është përfutur nga nëna ime, si bashkëpronare. |
| Të ardhura të fituara nga dhurimi i bërë nga nëna ime shtetësjë [redacted] i shumës 1 000 000 (një milion) lekë. Kjo shumë më është dhuruar nga nëna ime, nga të ardhurat e siguruar prej saj nga shitja e apartamentit të sipërcituar, pasurisë nr. [redacted] si bashkëpronare. Kalimi në llogarinë time bankare është bërë në datat 13.11.2019 dhe 15.11.2019.                                     | 1 000 000 (një milion) lekë.                                                                                                                                                                                        |
| Të ardhura nga paga si Gjyqtare e bashkëshortes Esmeralda Xhili për vitin 2019.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                       | 2 432 870 (dy milion e katërqind e tridhjetë e dy mijë e teteqind e shtatëdhjetë) lekë.                                                                                                                             |

*Nëse ky format është i pamjaftueshëm, vazhdoni të plotësoni në kopje të tij.*

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi i personit të lidhur

ALAN XHILI 

**DETYRIMET FINANCIARE  
NDAJ PERSONAVE JURIDIKË DHE FIZIKË**

- Detyrimet financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë (kredi, huamarrje, detyrim ndaj të tretëve etj.) që ekzistojnë brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë, të mbetura ende pa u shlyer nga deklarimi i mëparshëm deri në 31 Dhjetor të vitit të deklarimit, si dhe detyrimet e lindura gjatë vitit të deklarimit.
- Të dhënat për emra personash ndaj të cilëve personi i lidhur ka detyrime financiare, të pasqyrohen në faqen nr.11 për të ruajtur konfidencialitetin e tyre.


Përshkruani hollësisht qëllimin e detyrimit financiar, shumën totale në lekë apo në valutë, datën e fillimit dhe të mbarimit të detyrimit (muaji/viti), nr. e kontratës dhe interesin bazë. Për kreditë bankare shumën e kredisë (principal), kohëzgjatjen (muaji/viti) dhe kësti mujor.

| Përshkrimi i detyrimeve                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                        | Shuma e shlyer nga deklarimi i mëparshëm deri në 31 Dhjetor të vitit të deklarimit (me shifra dhe fjalë)             | Gjendja e detyrimit të mbetur pa shlyer deri në 31 Dhjetor të vitit të deklarimit (me shifra dhe fjalë)                                                                                   |
|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| Kredi e marrë pranë "Bank", sipas kontratës noteriale bankare dhe hipoteke me nr. rep. kol. datë 31.03.2017. Kjo kredi është marrë nga bashkëshortja ime Esmeralda Xhili (Çeka) si kredimarrëse dhe unë Alan Xhili, si bashkëkredimarrës. Kjo kredi është marrë përgjatë vitit 2017.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                           | Kredia është marrë në vlerën 8 700 000 (tetë milion e shtatëqind mijë) lekë.                                         | Gjendja e detyrimit të mbetur pa shlyer deri në datë 31.12.2019, është 7,469,641.40 (shtatë milion e katërqind e gjashtëdhjetë e nëntë mijë e gjashtëqind e dyzet e një pikë dyzet) lekë. |
| Përgjatë vitit 2019, është shlyer huaja e marrë nga ana ime, më parë, shtetasit (daja/vëllai i nënës time) sipas deklaratës noteriale me nr. rep. kol. datë 03.03.2017. Kjo hua është marrë përgjatë vitit 2017. Kjo hua është shlyer: 1) Vlera 1 500 (një mijë e pesëqind) euro në maj të vitit 2019, nga të ardhurat e pagës; 2) Vlera 10 500 (dhjetë mijë e pesëqind) euro, nga të ardhurat e fituara nga ana ime nga shitja e pasurisë në bashkëpronësi me nënën time, apartament (shtëpi banimi), numër pasurie 8/54+2-35, e ndodhur në rrugë "sh. k. aj. imë" me sipërfaqe 55.6 m <sup>2</sup> , nga shitja e së cilës, sipas kontratës noteriale me nr. rep. kol. datë 03.03.2017, është marrë një shumë prej 3 000 000 (tri milion) lekë, nga të cilat 2 500 000 (dy milion e pesëqind mijë) lekë, të cilat janë nga kursimet e pagës. | Huaja është marrë në vlerën 12 000 (dymbëdhjetë mijë) euro dhe është shlyer kjo vlerë totalisht përgjatë vitit 2019. | Vlera e huasë prej 12 000 (dymbëdhjetë mijë) euro është shlyer tërësisht përgjatë vitit 2019.                                                                                             |
|                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                |                                                                                                                      |                                                                                                                                                                                           |

Nëse ky format është i pamjaftueshëm, vazhdoni të plotësoni në kopje të tij.

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi i personit të lidhur

ALAN XHILI





## Informacion në ndihmën tuaj:

Detyrimi për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, interesave private, detyrimeve financiare të zyrtarëve dhe personave të lidhur me ta, sanksionohet në dy ligjet mbi të cilat ushtron veprimtarinë Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave:

- Ligj nr.9049, datë 10.4.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar
- Ligj nr.9367, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” i ndryshuar.

### Deklarimi i interesave private nga zyrtari

- Dokumenti zyrtar “Deklaratë e interesave private priodik/vjetor” duhet të plotësohet nga zyrtari në funksion, por edhe në rastet kur zyrtari ka patur ndërprerje për më pak se një vit nga funksioni i mëparshëm.
- Deklarimi përfshin pasurinë e subjektit dhe të familjes së tij (bashkëshortit/es, bashkëjetuesi/es dhe fëmijëve në moshë madhore), burimet e krijimit dhe detyrimet financiare të subjektit.
- Kur pasuria e pjesëtarëve të familjes është e ndarë dhe e regjistruar si e tillë në organet e administratës shtetërore ose gjyqësore, deklarimi paraqitet veçmas nga çdo anëtar i familjes, me pasuri të regjistruar në emër të vet dhe i bashkëlidhet deklaratës së personit që ka detyrimin për deklarim.
- Formulari i deklarimit plotësohet vetëm në mënyrë elektronike (me kompjuter). Pas printimit të formularit të plotësuar sipas kërkesave ligjore, bëhet nënshkrimi për çdo fletë të tij, sipas rubrikave përkatëse.
- Subjekti/zyrtar nuk legjitimohet të nënshkruajë deklaratën e interesave private të personave të lidhur.
- Deklarata duhet të plotësohet dhe dorëzohet, deri më 31 Mars të çdo viti.

Bashkëlidhur Deklarimit të interesave private zyrtari duhet të dorëzoj: kopje të Letër Njoftimit ( Kartës së Identitetit) për vete, për bashkëshortin/en, bashkëjetuesin/en, fëmijët në moshë madhore.

Për fëmijët e tjerë zyrtari duhet të dorëzoj fotokopje të Pasaportës ose të Çertifikatës personale.

Mosplotësimi i këtij detyrimi passjell mospranimin e deklaratës së interesave nga ILDKPKI

dhe për pasojë ndaj zyrtarit do të aplikohen sanksione për refuzim të deklarimit të interesave private.

### Deklarimi i interesave private nga personi i lidhur me zyrtarin

- Dokumenti zyrtar “Deklaratë e interesave private e personit të lidhur” duhet të plotësohet nga personat e lidhur (bashkëshortit/es, bashkëjetuesit/es dhe fëmijëve në moshë madhore) që mbartin detyrimin për deklarim në bazë të nenit 21 dhe 22 të ligjit nr.9049, datë 10.04.2003, për pasuritë që disponojnë veçmas.
- Subjekti/Personi i lidhur me zyrtarin, (bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi/ja, fëmijët në moshë madhore) i cili mbart detyrimin për deklarim të interesave private në Inspektoratin e Lartë, plotëson formularin përkatës nga faqja 8-11.
- Në çdo rast, subjekti deklarues personi i lidhur është i detyruar të plotësojë faqen e parë të deklaratës “AUTORIZIMI”, ku deklaron nëse ka ose jo pasuri të regjistruara në emrin e tij. Formulari i plotë do të plotësohet vetëm në rastet kur personi i lidhur ka pasuri të regjistruar veçmas.

### Sanksionet:

- Çdo shkelje e detyrimeve të përcaktuara në ligj, përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë sipas nenit 40 të Ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, i ndryshuar
- Për mosdeklarim në afat dhe pa shkaqe të arsyeshme, deklaruesi dënohet me gjobë nga 50.000 lekë deri në 100.000 lekë.
- Refuzimi për deklarim nga zyrtari, sjell humbjen e funksionit dhe ndëshkimin në përputhje me nenin 257/a të Kodit Penal.
- Refuzimi për deklarim nga personi i lidhur dënohet me gjobë dhe ndëshkohet sipas nenit 257/a të Kodit Penal
- Deklarimi i rremë apo fshehja e pasurisë përbën vepër penale dhe dënohet sipas legjislacionit në fuqi.

**Kujdes:** Të gjitha faqet e formularit të deklarimit duhet të nënshkruhen nga deklaruesi në të kundërt, deklarata do të kthehet dhe do të konsiderohet e pa dorëzuar në Inspektoratin e Lartë.

- Për informacione të mëtejshme apo asistencë në plotësimin e deklaratës, kontaktoni në Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive me “Sektorin e Marrëdhënieve me Autoritetet Përgjegjëse” në numrat e telefonit **042 259 461**, Falas 08009999, [info@hidaa.gov.al](mailto:info@hidaa.gov.al) .
- Të dhënat e deklaratës lejohet të publikohen sipas ligjit.